



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:174711
Datë: 12.03.2024
Numri i dokumentit: 05439693

Rev.nr.33/24

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Zenel Leku dhe Beshir Islami, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit: L. I. nga fshati S., Komuna e G., të cilin e përfaqëson R. P., avokat në P., sipas autorizimit, kundër të paditurës: K. e S. “...” me seli në P., Rruga “...” nr. ..., të cilën e përfaqëson V. R., sipas autorizimit, për kompensim dëmit jo material dhe material, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.7233/2022, të datës 02.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 07.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. PRANOHET pjesërisht revizioni i të paditurës: K. e S. “...”, me seli në P., Rruga “...”, nr. ..., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.7233/2022, i datës 02.11.2023 dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Glllogoc C.nr.449/18, i datës 09.08.2022, NDRYSHOHEN në pjesën e kërkesëpadisë që ka të bëjë me kamatën e gjykuar ashtu që: DETYROHET e paditura që paditësit t’ia paguajë kamatën ligjore prej 8 % duke llogaritur për dëmin material nga dita e ngritjes së padisë më datë..., ndërsa për dëmin jomaterial nga nxjerrja e aktgjykimit të shkallës së parë më datë ..., e deri në pagesën definitive, nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kanosjen e përmbarimit ligjor.

II. Refuzohet i pabazuar revizioni i të autorizuarit të paditurës: K. e S. “...”, me seli në P., rruga “...”, nr.20, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.7233/2022, të datës 02.11.2023, në pjesën tjetër të aktgjykimit të goditur.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Glllogoc C.nr.449/18, të datës 09.08.2022, është vendosur: I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit L. I nga fshati S., Komuna e G. dhe detyrohet e paditura K. e S. “...”, me seli në P., rruga “...” nr. ..., që paditësit në emër të kompensimit të dëmit për lëndimet e pësuar në aksidentin e trafikut të datës ..., ti paguaj dhe atë: në emër të dhimbjeve fizike shumën prej ... €, në emër të frikës së përjetuar shumën prej ... €, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallen prej 3 % shumën prej ... €, në emër të ndihmës së personit tjetër shumën prej ... €, në emër të ushqimit të përforcuar shumen prej ... €, në emër të shpenzimeve të mjekimit shumën prej ... €, në emër të zvogëlimit të aftësisë punuese prej 3%, fitimit të munguar nga dita e aksidentit ... e deri më ... shumën prej ... €, të gjitha këto shuma të miratuara si nën pikën I/A dhe I/B të dispozitivit, të këtij aktgjykimi, e paditura është e detyruar që paditësit t’ia paguaj me kamatë ligjore prej 8 % llogaritur nga dita e ngritjes së padisë më datë ... , e deri në pagesën definitive në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kanosjen e përmbarrimit ligjor. Detyrohet e paditura që paditësit t’ia kompensoj dëmin material në emër të zvogëlimit të aftësisë punuese në shkallën prej 3 % nga data ..., shumën prej ... € për çdo muaj derisa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore. II. Detyrohet e paditura që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej ... €, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kanosjen e përmbarrimit ligjor. III. Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit e cila ka të bëjë për kompensimin e dëmit jomaterial në shumën më të lartë se sa shuma e aprovuar si në pikën I/A të dispozitivit të këtij aktgjykimi shumat si vijon: në emër të dhimbjeve trupore fizike shumën prej ... €, në emër të frikës së përjetuar shumën prej ... €, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën prej 3 % shumën prej... €, si dhe për dëmin material në shumën më të lartë se sa shuma e aprovuar si në pikën I/B të dispozitivit dhe atë: në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej ... €, në emër të shërimit klimatik-fizioterapeutik shumën prej ... €.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.7233/2022, të datës 02.11.2023, është vendosur: Refuzohen si të pabazuara, ankesa e paditësit L. I nga fshati S., Komuna e G. dhe ankesa e të paditurës K. e S. “...”, me seli në P., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc, C.nr.449/18 i datës 09.08.2022, vërtetohet.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizion e paditura, për shkak shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në shkallën e dytë dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që revizioni i të paditurës të aprovohet si i bazuar, të ndryshohet aktgjykimi i Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Glllogoc C.nr.449/18 i datës 09.08.2022 i vërtetuar nga Gjykata e Apelit Ac.nr. 7233/2022 i datës 02.11.2023, sa i përket shumave të gjykuara dhe të zbriten të gjitha format e dëmit në proporcion me dëmin e pësuar, po ashtu të zbriten edhe shumat e gjykuara sa i përket shpenzimeve gjyqësore dhe të njëjtat të gjykohen sipas tarifës së Odës avokateve OAK-së, ose të njëjtat kthehen në rigjykim për vendosje. Të refuzohet kërkesëpadia sa i përket dëmit material fitim i munguar ose lënda për këtë formë të dëmit kthehet në rigjykim

Me përgjigje në revizion paditësi, ka kërkuar që revizioni i të paditurës të refuzohet në tërësi i pabazuar dhe të vërtetohen aktgjykimi i shkallës së parë dhe i shkallës së dytë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i të paditurës është pjesërisht bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, më datë 13.12.2018, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitë padi, kundër të paditurës, me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jo material, duke kërkuar shumat e specifikuara më saktësisht si në precizimin e padisë me parashtrësën e datës

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësit kundër të paditurës, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.449/18, të datës 09.08.2022, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsytim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ka theksuar se, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike ka administruar këto provave: kopjen e letërnjoftimit të paditësit L. I., raportin e aksidentit nr.... të datës ..., skicën nga vendi i ngjarjes me nr. ... të datës ..., kopjen e patentë shoferit të paditësit L. I., librezën e regjistrimit të automjetit të paditësit, policë e sigurimit KS – S. e vlefshme nga data ... e deri më datë ..., akt ekspertizë e dëmit e KS “ ...”, e datës ..., dy fotografi të veturës së dëmtuar, certifikatën mbi aftësimin profesional në Qendrën për Aftësim Profesional “Pedagogu”, në G. të datës ..., certifikatën e regjistrimit të biznesit të datës ..., raportin mjekësor të Klinikës Emergjente në Prishtinë të datës 28.10.2018 për paditësin L. I., fletëlëshimin e QKUK-së, në Prishtinë me nr. ... të datës..., raportin specialistik nga specialisti i ortopedisë Dr. Luan Kuqi të datës ..., raportin e QKF-së në K. të datës ..., raportin mjekësor të QKMF-së, në K. të datës ..., raportin mjekësor të Klinikës E. të datës..., kuponin fiskal për vizitë mjekësore të Klinikës E. të datës..., kuponin fiskal për vizitë mjekësore të Klinikës E. të datës ..., kuponin fiskal të klinikës “Sh Hasi”, të datës ..., faturën mjekësore me numër ... për paditësin L. I. nga klinika “Sh. Hasi”, faturën mjekësore të datës ... dhe ...nga ordinanca mjekësore A., kuponin fiskal të ordinancës mjekësore A. të datës..., kuponin fiskal të Dr. Sh.Hasi të datës..., fotografinë e paditësit me lëndime në kokë, aktgjykimin e kësaj gjykate P.nr.40/2019 të datës 27.02.2019, i cili ka marrë formën e prerë më datë 26.03.2019, ekspertizën e komunikacionit rrugor të ekspertit të komunikacionit B. B. nga lëmia penale me shenjën PP/II.nr.7117/18 të datës..., ekspertizën e vlerësimit të dëmit në automjet e ekspertit të makinerisë Q. A. e dorëzuar në gjykatë më datë..., ekspertizën mjekësore të lëmisë së psikiatrisë të Dr. G. H. dhe lëmisë së ortopedisë me Dr. S. D. të datës..., sqarimin e ekspertit të ortopedisë Dr. A. T. në seancën e datës..., për paditësin L. I., ekspertizën mjekësore nga lëmia e mjekësisë së punës e ekspertit A. H. të dorëzuar në gjykatë më datë..., sqarimin e ekspertit të lëmisë së mjekësisë së punës A. H. në seancën e datës..., pasqyrën e trustit pensional për paditësin L. I. e datës ..., gjendjen e përgjithshme të deklarimeve dhe transaksioneve tjera të lëshuara nga Administrata Tatimore e Kosovës për paditësin L. I. të datës ..., në dy fletë, ekspertizën e ekspertit të akuaristikës A. B. të datës., sqarimin e ekspertit të akuaristikës A. B. në seancën e datës... .

Ka shtuar se për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë së paditësit gjykata sipas propozimit të palëve, në cilësinë e provave materiale ka nxjerrë ekspertizat mjekësore me ekspertët Dr. G. H.- ekspert i psikiatrisë, Dr. S. D.-ortopend, të cilët pas ekzaminimit të drejtpërdrejt të paditësit kanë dhënë mendimin e tyre profesional lidhur me natyrën, shkallën, pasojat e lëndimeve dhe frikën

që ka pësuar paditësi si pasojë e këtij aksidenti. Ekspertet S. D.-ortoped në ekspertizën e tij të punuar me shkrim të datës ... lidhur me natyrën, shkallën dhe pasojat e lëndimit L. I. të pësuar në aksidentin e lartcekur ka deklaruar se paditësi ka pësuar këto lëndime: thyerje e zgjatimit transvers të unazës së pestë të qafës C, ana e djathtë; ndrydhje e regjionit të kokës dhe qafës, ndrydhje të regjionit të krahut të majtë të cilat lëndime bëjnë pjesë në lëndime të rënda trupore, si pasojë e të cilave lëndime paditësi ka pësuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje 1 orë si pasojë e lëndimeve të lartcekura, posaçërisht thyerjes së zgjatimit transvers të pestë të qafës, mekanizmit të aksidentit, dhënies së ndihmës së parë dhe mënyrës së transportit, me intensitet të rëndë me kohëzgjatje prej 48 orësh me theks të veçantë në regjionin e kokës, qafës, krahut të majtë, me intensitet të mesëm kanë qenë prezentë prej ... javësh, me intensitet të ulët dhimbjet janë prezentë edhe tani sidomos gjatë ngarkesave fizike, pozitive të detyruara dhe ndryshimeve klimatike. Shëmtim trupor nuk ka edhe pse në foto dokumentacionin kanë qenë prezentë shenja të gjakderdhjes nënëlkurore në regjionin e ballit ana e majtë po që në momentin e ekzaminimit si pasojë e rikuperimit janë tërhequr dhe nuk janë evidente. Si pasojë e lëndimeve paditësi ka pësuar zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën prej 7% dhe atë duke u bazuar në kapitullin 3 pika 3 nënpika 3.1.2b të tabelës për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor të miratuar MSH dhe BQK, e duke bërë përllogaritjen sipas Formulës së Baltazarit që konsiston në zvogëlimin e lëvizshmërisë së pjesës me instabilitet. Ndihma e personit të tretë-21 ditë që nënkupton ndihmën mjekësore profesionale dhe jo profesionale nga anëtarët e familjes. Ushqimi i përforcuar-21 ditë (ushqim i pasuruar me proteina, minerale, vitamina, karbohidrate) të nevojshme për sanimin e lëndimit si dhe reaksionit pos traumatik. Rehabilitimi fiziatriko-psikik-nga 14 ditë i nevojshëm për përmasimin e lëvizjeve të qafës dhe krahut të majtë si dhe rritjen e forcës dhe masës muskulare. Eksperti i psikiatrisë G. H. në ekspertizën e datës ... lidhur me frikën e përjetuar të paditësit si pasojë e aksidentit ka dhënë mendimin e tij se paditësi nuk ka pasur frikë primare ngase nuk e ka vërejtur automjetin paraprakisht derisa e ka goditur në anën e majtë, frikë sekondare të intensitetit të lartë është frika në vazhdim nga momenti i aksidentit, përcjellja e tij fillimisht në QKMF, në Drenas, e pastaj përcjellja në QE, në Prishtinë, dhënia e ndihmës adekuate mjekësore, ekzaminimet e nevojshme mjekësore, frikë sekondare e intensitetit të mesëm është frika në vazhdim pas lirimimit në shtëpi, dhimbjet e herëpashershme në regjionin e lëndimit, dhimbje koke, marramendje, problemet me gjumin, gjendjet e ankthit, frikës dhe shqetësimit permanent se nga lëndimi i pësuar do të mbetet me pasoja tërë jetën, frika sekondare e intensitetit të ulët është prezentë edhe sot derisa intervistohet dhe frika intensifikohet sidomos kur kalon në vendin e ngjarjes si dhe kur vozitë dhe vozitet nga të tjerët.

Eksperti i ortopedisë Dr. A. T. në seancën e datës ... konstaton se paditësi L. I. në aksidentin e datës ... ka pësuar këto lëndime; thyerje të procesit transvers të djathtë të unazës së 5 të qafës, dëmtim të aparatit ligamentar të regjionit të qafës, ndrydhje e regjionit të ballit e shoqëruar me gjakderdhje nënëlkurore. Lëndimi kualifikohet si lëndim i natyrës së rëndë trupore. Në momentin e pësimit të aksidentit janë shkaktuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë të cilat kanë zgjatur rreth 60 minuta duke pasur parasysh natyrën e lëndimit, prej momentit të aksidentit, kohën e transportit dhe fillimin e ofrimit mjekësor profesional. Dhimbjet fizike të intensitetit të rëndë të cilat kanë zgjatur për 48 orë apo dy ditë, kohë pas kohe deri në veprimin e terapisë së ordinuar. Dhimbje fizike të intensitetit të mesëm të cilat kanë zgjatur për 21 ditë

apo 3 javë, kohë e cila është e nevojshme për tërheqjen e edemës, spazmës muskulare, konsolidimit primar të kockës dhe indeve të aparatit ligamentar, nën veprimin e terapisë. Dhimbje fizike të intensitetit të ulët të cilat shfaqen edhe sot herë pas here sidomos gjatë sforcimeve fizike në duar dhe në ndryshimin e kushteve klimatike, sipas të dhënave anamnestike të paditësit. Shëmtimi trupor nuk ekziston. Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor ekziston në shkallën 3% bazuar në tabelën e aprovuar nga MSH dhe BQK, në kapitullin III, pika 3.1.1, ky zvogëlim manifestohet me kufizim të lëvizshmërisë të regjionit të qafës në shkallë të lehtë pas lëndimit të aparatit ligamentar dhe pa instabilitet tek paditësi. Ndihma dhe përkujdesja e personit tjetër ka qenë e nevojshme në periudhën prej 21 ditësh apo 3 javë për ti kryer disa aktivitete të përditshme jetësore i ndihmuar nga familjarët, për shkak të mbajtjes së detyruar të i mobilizimit në regjionin e qafës. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 3 javë i pasur me minerale, albumina, vitamina, karbohidrate, ushqim me tepër i forcuar se ushqimi i zakonshëm. Rehabilitimi fiziko-terapeutik ka qenë i nevojshëm dy herë nga 10 ditë brenda vitit pas aksidentit me qëllim të rritjes së atitudës së lëvizjeve në regjionin e qafës, rikthimin e forcës dhe masës muskulare.

Eksperti i mjekësisë së punës Dr.A. H., në ekspertizën e tij të datës ... ka konstatuar se për paditësin ka bërë vlerësimin e paaftësisë aftësisë së punës së përkohshme dhe përhershme për punën që e ka punuar dhe punon pas aksidentit të trafikut të datës... Nga dita e aksidentit e plotë një muaj e gjysmë, deri më datë ... paaftësia e përkohshme ka qenë e plotë 100%, për shkak të hospitalizimit, dhimbjeve të qafës dhe krahut të djathtë, diagnostikimit, trajtimit, imobilizimit të qafës, palëvizshmërisë etj. Ndërsa pas datës ... e deri më datë ... që do të thotë edhe dy muaj e gjysmë paaftësia e përkohshme por e përsëritshme për punën e automekanikut ka qenë në shkallë prej 30%, për shkak të rikuperimit jo të mirë të gjendjes pas thyerjes së unazës C/5 dhe i instabilitetit të ligamenteve të qafës, por paaftësia e pjesshme ka qenë pasi disa punë ka mundur ti kryej por shumicën e punëve të rënda jo. Pas datës ... kur ka filluar punën e njëjtë e deri në ditën e ekzaminimit tim, tani aftësia e përhershme për punën e automekanikut është zvogëluar për 10%, për shkak se akoma ka pengesa në ngritjen e dorës së djathtë, dhimbjen e qafës në pozitë retorflaksi ku në procesin e punës së automekanikut janë pozita të detyruara trupore. Në seancën e datës ... , eksperti i mjekësisë së punës ka sqaruar se me rastin e përcaktimit të shkallës së zvogëlimit të aftësisë punuese të pacientit duhet të merret për bazë dëmtimi trupor lëndimi ose thyerja ndërsa rregullorja e BQKS-së, merret vetëm si pikënisje për të bërë vlerësime të tjera dhe e njëjta nuk është obligative. Zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor nuk e përcakton shkallën e invaliditetit gjegjësisht të paaftësisë për punë në rendë të parë që paditësi e ka ushtruar para aksidentit eventualisht e ushtron edhe pas aksidentit ose do ta kishte ushtruar po të mos kishte ndodhë aksidenti dhe e fundit është profesioni i paditësit kur është i dëshmuar ai që dikton edhe vlerësimin e paaftësisë për punë në rastin konkret paditësi e ka pohuar dhe vërtetuar se si profesion para aksidentit e ka pasur të kryer drejtimin e automekanikut edhe pas aksidentit jo shumë gjatë pas ndodhjes paditësi ka pohuar se të njëjtin profesion e ushtron edhe tani e tutje andaj themeloria në këtë rast është të vlerësohet paaftësia e përkohshme për punë të automekanikut të cilën e ushtron. Eksperti pastaj ka theksuar se me rastin e dhënies së mendimit të tij për zvogëlimin e aftësisë punuese të paditësit është bazuar kryesisht në raportet mjekësore dhe pas ekzaminimit të paditësit sepse raporti i ortopedit nuk hyn fare në mendimin tim sepse ajo është vetëm pikë orientuese. Nuk ekzistojnë tabela për vlerësimin e aftësisë- paaftësisë për

punë por tabelat janë vetëm për vlerësimin e aktivitetit jetësor gjegjësisht dëmtimin trupor, ndërsa mendimin për aftësinë-paafhtësinë punuese e kam bazuar në literaturën e mjekësisë së punës që është profesioni im dhe referencat që janë po në atë libër që duhet të merren gjithëherë parasysh kur bëhet vlerësimi i paafhtësisë aftësisë për punë dhe tema kryesore që merret për bazë është puna e të dëmtuarit që e ka punuar, e punon dhe do ta punoj.

Eksperti financiar Prof. A. B., në ekspertizën e tij të datës ... ka dhënë mendimin se bazuar në profesionin e paditësit të cilin e ushtron që nga..., tri vite para se të aksidentohej e meqë nga historiku i biznesit të tij e sidomos nga pasqyra e kursimeve të tij pensionale në Trust, shihet se ai ATK-së, i ka deklaruar qarkullimin prej nga (...) x ... për çdo tre muaj që i bie nga ...€ në muaj mesatarisht dhe ka vlerësuar se fitimi i tij i humbur në shkallë të invaliditetit prej 100%, ku mundur të jetë prej nga ... €, në muaj të cilën e ka marrë për bazë me rastin e llogaritjes së fitimit të munguar. Duke u bazuar në invaliditetin punues të paditësit të vlerësuar nga eksperti i mjekësisë së punës dhe atë gjatë 1.5 muajve të parë pas aksidentit për 100%, gjatë 2.5 muajve tjerë në vijim prej 30%, dhe pas 4 muajve përherë prej 10 %, në të cilin proporcion nga baza e të ardhurave të tij mujore nga ... €, fitimi i tij i humbur do të jetë për periudhën e kaluar prej aksidentit të datës ... e deri më tani ... arrin në shumën prej ... €, dhe për periudhën e ardhshme prej datës ... e tutje derisa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore, renta mujore do të jetë nga ... €, në muaj e cila e paguar në formë të menjëhershme-të kapitalizuar do të jetë ... €, ashtu që shuma e gjithmbarshme e fitimit të humbur për periudhën e kaluar së bashku me kamatë dhe për periudhën e ardhshme e paguar në formë të menjëhershme arrin vlerën prej: ... € ...€. Eksperti financiar në seancën e datës ... , ka sqaruar se ekzistojnë prova materiale në shkresat e lëndës se menjëherë pas aksidentit ka pasur rënie në qarkullimin e biznesit të paditësit për 30%, në raport me kuartarin paraparak para se të aksidentohet e cila periudhë ka zgjatur. Deri në atë kohë i njëjti ka pasur shkallë të lartë të invaliditetit punues.

Ekspertizat e ekspertëve të lëmisë së ortopedisë (ekspertit A. T.), psikiatrisë, mjekësisë së punës dhe atë të aktuaristikës, gjykata i ka marr në tërësi si të bazuara dhe i dha besimin e plotë ngase ekspertizat përmbajnë elementet e nevojshme të dhëna në bazë të njohurive profesionale dhe arsyeve të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoj sit ë drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Gjykata pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat e administruara që i referohen natyrës dhe pasojave të lëndimeve të pësura nga paditësi si pasojë e aksidentit e duke marrë për bazë mendimin e ekspertëve mjekësor lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë dhe për kategoritë e caktuara të dëmit jomaterial, gjykata vendosi në kuptim të nenit 183 të LMD-së. Me këtë rast gjykata pati parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës, dhe qëllimin të cilit i shërben kompensimi i gjykuar, gjithmonë duke pasur parasysh, që kompensimi të jetë satisfaksionin, për të dëmtuarin, duke ndikuar kështu në zbutjen e pasojave negative që janë paraqitur si pasojë e dëmit në cenimin e vlerave personale të paditësit. Gjykata pasi konstatoi rrethanat e rastit duke pasur parasysh, natyrën e rëndë të lëndimeve, sidomos zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën prej 3% dhimbjet e përjetuara fizike, llojet e dhimbjeve, intensitetin dhe kohëzgjatjen e tyre, natyrën, shkallën dhe pasojat e lëndimeve, intensitetin dhe kohëzgjatjen e frikës, shëmtimin trupor, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor e duke marr për bazë edhe rrethanat tjera

që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit, si dhe moshën e tij, praktikën e mirë gjyqësore, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit në pjesën e aprovuar.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlidhet me dëmin jomaterial, gjegjësisht për dhimbjet fizike dhe frikën e përjetuar të paditësit, për shëmtim, si dhe për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, gjykata vendosi, si në pikën II, në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që vlerësoi se kompensimi përtej shumës së gjykuar, nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur, dhe me qëllim që kompensimi të ishte i drejtë.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 136.1, 159, 169, 172, 173, 174, 179, 183 dhe 382 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Lidhur me shpenzimet ka vendosur në bazë të nenit 449 dhe 452 të LPK-së. Për kamatë ligjore ka vendosur në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, paditësi dhe e paditura kanë paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.nr.7233/2022, të datës 02.11.2023, ka vendosur që të refuzoj ankesat e palëve ndërgjyqëse, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsyetim të aktgjykimit Gjykata e Apelit ka theksuar se: nisur nga gjendja e vërtetuar faktike kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të provave të administruara të ofruara nga palët ndërgjyqës, ka marrë aktgjykimin i cili sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës së Apelit është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye konkrete edhe për faktet vendimtare duke dhënë shpjegimet dhe arsyet adekuate për një vendosje të këtillë bazuar në dispozitat përkatëse ligjore që i referohen kësaj çështje kontestuese. Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të ligjshëm e miraton në tërësi edhe kolegji i gjykatës së shkallës së dytë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe se në rastin konkret është bërë zbatim i të drejtës materiale në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Kolegji ka vlerësuar se ankesa e të paditurës e cila ka atakuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë shfaqet e pa bazuar pasi që gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e vendimit gjyqësor ka dhënë arsye të plota lidhur me mënyrën e vendosjes duke u mbështetur në provat e nxjerra, nga të cilat është vërtetuar se në aksidentin e komunikacionit të datës... , paditësi ka pësuar dëmin e përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit ankimor.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimet e instancave më të ulëta nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Pretendimet e paraqitura në revizion se aktgjykimet e instancave më të ulëta janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të bazuara, për shkak se aktgjykimet në strukturë dhe përmbajtje janë në përputhje me nenin 160 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjeshme të kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Për shkakun e njëjtë nuk qëndrojnë as pretendimet në raport me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, sepse gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi. Gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozita ligjore, por ka gjetur me të drejtë se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata e shkallës së parë dhe të dytë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat përkatësisht faktet e çështjes, mbi bazën e të cilave ka krijuar një pasqyrë të qartë, nga e cila ka rrjedhë se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, për arsye se:

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësit, gjenë mbështetje në nenin 136, 140, 169, 172, 173 dhe 183 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i datës 10 maj 2012, i cili ka hyrë në fuqi me datë 20 dhjetor 2012.

Me nenin 136 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij ”.

Me nenin 140 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia ”.

Me nenin 169 paragraf 1, 2, 3 dhe 4 të këtij ligji, përcaktohet se: “ 1. Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. 2. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla. 3. Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t'ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit. 4. Gjykata do t'i gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme ”.

Me nenin 173 të këtij ligji, përcaktohet se: “ 1. I dëmtuari ka të drejtë si për shpërblimin e dëmit të rëndomtë, ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur. 2. Lartësia e shpërblimit të dëmit caktohet sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor, përveç nëse me ligj parashihet diçka tjetër. 3. Gjatë vlerësimit të lartësisë së fitimit të humbur merret në konsiderim fitimi që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas rrjedhjes së rregullt të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta, e realizimi i të cilit është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga lëshimi që të ndërmer veprimin. 4. Kur sendi është shkatërruar ose dëmtuar me vepër penale të kryer me dashje, gjykata mund të caktojë lartësinë e shpërblimit sipas vlerave që ka pasur sendi për të dëmtuarin.

Me nenin 183 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, përcaktohet se: “1. Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. 2. Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore dhe nga provat që gjenden në shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë me të drejtë kanë vendosur kur e kanë aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit lidhur me kompensimin e dëmit, me rastin e aksidentit të shkaktuar me fajin e të siguruarit të paditurës të shkaktuar më datë 28.10.2018. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, kërkesëpadia e paditësit në raport me të paditurin është pjesërisht e bazuar sipas dispozitave ligjore të lartcekura.

Përveç të cekurave në këtë rast baza juridike e kërkesëpadisë gjënë mbështetje në nenin 136 të LMD-së, për arsye se: Dëm konsiderohet vetëm dëmi i cili si i tillë pranohet nga e drejta. Kështu dëmi përfaqëson dëmtimin që e pëson një person i caktuar në të mirën juridike që mund të jenë personale dhe pasurore, me kusht që ato të jenë juridikisht të mbrojtura. Përndryshe dëmtimi përbën jo vetëm cenim të të drejtave, por edhe cenim të interesave, nëse ai është bërë në kundërshtim me të drejtën. Nga vetë përmbajtja e nenit 136 të LMD-së, rezulton se ai që i shkakton dëm tjetrit ka detyrim t’ia shpërblejë atë. Sipas kësaj dispozite për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit është e nevojshme të jetë shkaktuar dëmi, të dihet shkaktari i tij dhe të ekzistojnë parakushtet e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit mbi bazën e fajësisë apo mbi ndonjë bazë tjetër ligjore. Për të ekzistuar detyrimi për kompensimin e dëmit duhet të plotësohen këto parakushte: a) që të shkaktohet dëmi; b) që dëmi të jetë shkaktuar me veprimin/mosveprimin e kundërligjshëm; c) të ekzistojë faj i dëmtuesit; d) që të ekzistojë aftësia delikatore dhe e) të ekzistoj lidhja kauzale ndërmjet veprimt/mosveprimt të kundërligjshëm dhe dëmit. Në këtë rast janë plotësuar këto parakushte ligjore për të ekzistuar përgjegjësia e të paditurës, për kompensimin e dëmit, paditësit.

Për pjesën e kërkesave për dëmin jomaterial për të cilat pretendon e paditura në revizionin, Gjykata Supreme Kosovës vlerëson se në kuptim të dispozitave materiale - juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë dhe e shkallës së dytë e në përputhje me gjendjen faktike, drejt është zbatuar e drejta materiale, për arsye se në çdo rast për dëmin jomaterial, gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimin të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi t’i shkoj përshtati synimeve që synohen me kompensimin e dëmit jomaterial e që është satisfaksion për të dëmtuarit. Mbi këtë bazë duke e pasur parasysh natyrën e lëndimeve që ka pësuar paditësi, llojin dhe kohëzgjatjen e dhembjeve fizike, frikën dhe mënyrën se si është manifestuar frika, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, si dhe rrethanat tjera si moshën e paditësit dhe praktikën e mirë gjyqësore, e të cilat rrethana janë në pajtim të plotë me nenin 183 të LMD-së, rezulton se shumatat e gjykuara

janë në përputhje me qëllimin e kompensimit. Në këtë rast vlerësohet se gjykata e shkallës së parë dhe të dytë kanë vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumave të gjykuara dhe natyrës së lëndimeve përkatësisht dëmeve që ka pësuar paditësi, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për të, dhe duke shmangur qëllimet tjera materiale (lukrative) që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit në raste të tilla.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata e shkallës së parë dhe e dytë me rastin e vendosjes, drejtë kanë aplikuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, lidhur me pjesën e kërkesëpadisë për kompensimin në formë të rentës së arritur në emër të zvogëlimit të aftësisë punuese prej 10%, fitimit të munguar nga dita e aksidentit ...e deri më ... shumën ...€, dhe nga data..., shumën prej ... €, për çdo muaj derisa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore për arsye se me nenin 172 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, përcaktohet se: “ Në rast të vdekjes, të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit, shpërblimi caktohet, sipas rregullës, në formë të rentës në të holla, për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar. 2. Renta në të holla e gjykuar në emër të shpërblimit të dëmit paguhet për çdo muaj përpara, në qoftë se gjykata nuk cakton diç tjetër”. Në këtë rast gjykata duke iu referuar kërkesës së paditësit ka lejuar që me anë të ekspertizës financiare - të aktuaristikës të bëhet llogaritja e rentës së arritur për pagesë dhe llogaritjes së rentës mujore për periudhën e ardhshme dhe nga kjo ekspertizë gjykata ka konstatuar se fitimi i humbur - renta e arritur për periudhën kohore nga data ...e deri më..., është në shumën prej ...€, dhe nga data..., shumën prej ...€ për çdo muaj derisa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore. Gjykata Supreme e Kosovës e ka pranuar rentën edhe për periudhën e ardhshme duke pas parasysh ekspertizën e cila vlerësimin e ka mbështetur në rrethanën objektive për t’ a nxjerrë lartësinë dhe atë në shkallën e zvogëlimit të aktivitetit punues dhe në këtë kuptim eksperti iu ka referuar të ardhurave mesatare të punëtorëve të pakualifikuar në Kosovë. Gjykata Supreme e Kosovës e pranon si të besueshme, profesionale dhe të argumentuar mirë ekspertizën e aktuaristikës dhe vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë për këtë kategori të dëmit sepse vlerësimi i gjykatës është në harmoni edhe me vlerësimin e ekspertit mjekësor i cili ka konstatuar se paditësi ka shkallë të zvogëlimit të aktivitetit punues 10%.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes, drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar lidhur me pjesën e kërkesëpadisë rreth kompensimit të dëmit material dhe atë: për ndihmën dhe kujdesin e personit të tretë dhe për ushqimin e përforcuar, për arsye se me nenin 179 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur më këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të pa aftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit”. Në këtë rast paditësi i takon e drejta në kompensimin e dëmit material, për ndihmën dhe kujdesin e huaj dhe ushqimin e përforcuar, përkundër faktit se paditësi për këto kategori të dëmit nuk ka prezantuar prova konkrete materiale, kjo gjykatë vlerëson se duke u nisur nga praktika e gjertanishme e gjykatave në Kosovë, në bazë të së cilës është konstatuar se në shumicën dërmuese të rasteve palët kanë të pamundur apo shumë të vështirë që të sigurojnë dëshmi konkrete për këtë lloji dëmi, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm është vështirë të argumentohet me prova konkrete, gjykata ka konstatuar se në këtë rast paditësja ka pasur nevojë për ndihmën dhe kujdesin e personit të tretë në kohëzgjatje prej 21 ditë dhe

ushqimi të përforcuar në kohëzgjatje prej 21 ditë, dhe të njëjtit i takon ky lloj kompensimi i kërkuar në shumat e gjykuara. Ndërsa në këtë rast lartësia e kërkesës për këto kategori të dëmit është reale në raport me kohëzgjatjen për nevojën për ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë dhe ushqimin e përforcuar.

Në raport me pretendimin e të paditurës lidhur me zvogëlimin e aktivitetit punues në shkallë 3%, të shënuar në dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se i njëjti është një gabim teknik dhe kjo shihet qartë edhe nga ana e arsytimit të aktgjykimit të shkallës së parë dhe shumat e gjykuar për rentë është bërë mbi bazën e zvogëlimin të aktivitetit punues prej 10%, dhe si gabim teknik mund të përmirësohet në çdo kohë nga gjykata e shkallës së parë, qoftë sipas detyrës zyrtare apo sipas kërkesës së palës.

Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur nga e paditura, për të cilat ka konstatuar se kryesisht i referohen zbatimit të gabuar të së drejtës materiale sa i përket lartësisë së dëmit, fitimit të humbur - rentës së arritur dhe rentës për të ardhmen, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Kjo nuk do të thotë se në të ardhmen palët me ndryshimin e rrethanave nuk mund të kërkojnë ndryshimin e vendimit sa i përket rentës për të ardhmen dhe në këtë kuptim palët e as gjykata nuk mund të thirren në çështje të gjykuar - res iudicata, por ata në çdo kohë mund të kërkojnë ndryshimin e vendimit për rentën në të ardhmen me kusht që ata kanë për detyrë të vërtetojnë ndryshimin e rrethanave që kanë ekzistuar me rastin e caktimit të mbajtjes financiare.

Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, për të cilat ka konstatuar se kryesisht i referohen zbatimi të gabuar të së drejtës materiale që ka të bëjë me lartësinë e shumave të gjykuara palës paditëse në emër të dëmit material dhe jomaterial dhe fitimit të humbur - rentës së arritur dhe rentës për të ardhmen të gjykuar nga gjykata e shkallës së parë dhe të dytë sipas aktgjykimit të lartcekur, për të cilat kjo gjykatë nuk e ka parë të arsyeshme ti elaboroj secilën veç e veç, ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, siç ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi. Në këtë kontekst nuk janë pranuar pretendimet sipas revizionit nga i autorizuari palës së paditur, për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ngase sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, për këtë pjesë të kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë dhe të dytë në përputhje me gjendjen faktike kanë aplikuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale, duke i'u referuar nenit 179 dhe 183 të LMD-së.

Aktgjykimi është ndryshuar sa i përket kamatës sepse gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë gabimisht kanë aplikuar të drejtën materiale, prandaj Gjykata Supreme e Kosovës, ka vendosur si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi e duke iu referuar nenit 382 të LMD-së, dhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme, lidhur me kamatën, ashtu që është vendosur për dëmin material kamata të llogaritet duke filluar nga data e ushtrimit të padisë..., ndërsa për dëmin jomaterial duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë..., e deri në pagesën definitive, sepse pala paditëse për dëmin dhe lartësinë e tij sa i përket dëmit material, ka ra në dijeni në momentin kur është paraqitur padija ndërsa për dëmin jomaterial nga momenti kur gjykata e shkallës së parë ka vendosur me aktgjykim dhe nga ai moment kërkesa e saj për

kompensim dëmi është bërë e kërkueshme dhe konsiderohet se e paditura ka ra në vonesë për përmbushjen e detyrimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga e paditura nuk janë vlerësuar pasi që sipas nenit 214 paragraf 2, të LPK-së, përcaktohet se: “ Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike ”.

Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe pretendimet e tjera të revizionit, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u mbështetur në nenin 222 dhe 224.1 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Rev.nr.33/24, datë 07.03.2024.

Kryetar i kolegjit
Rrustem Thaqi